

VENDIM
Nr. 276, datë 1.4.2015

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES DHE MINISTRI TË SHTETIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE, TË PRONËS NR. 33, ME EMËRTIM “SHTËPIA E USHTARAKËVE”, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “ZHANË D’ARK”, TIRANË, PËR VENDOSJEN E QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT (QKR), QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, sipas përcaktimeve të mëposhtme, për një periudhë 35-vjeçare, të pronës nr. 33, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Zhan d’ Ark”, Tiranë, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, sipas planvendosjes dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e administratës së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe të Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

2. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes t’i jepet, në përdorim të përkohshëm, trualli funksional i pronës, bodrumi, kati përdhe, kati i parë, i dytë, i tretë dhe kati i katërt i godinës, sipas planvendosjes dhe planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e administratës së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe të Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL). Bodrumi do të përdoret nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) dhe nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).


3. Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike t’i jepet, në përdorim të përkohshëm, kati i pestë dhe i gjashtë i godinës, sipas planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për sistemimin e administratës së Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).


4. Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, sipas planvendosjes dhe planimetrive përkatëse, u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama





MIRATOHET

Drejtori i SHKENCES

Znj. Mirela



SHKENCES

SHKENCES

SHKENCES

SHKENCES

SHKENCES

SHKENCES

SHKENCES

SHKENCES

SHKENCES

SHKENCES

SHKENCES

A-06

1 : 100

Handwritten signature

Kati 0 OBORR

2715 m² TOI

987 m² sp. e mbulues

1728 m² sp. oborr

